

# **STATUTI DHE AKT THEMELIMI SHOQËRISË TREGTARE**

## **PREMAR ALB SHPK**

Në këtë statut:

- Ligji është Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- "Statuti" është statuti i shoqërisë;

### **Kreu I**

**Themelimi, emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

### **Neni 1**

**Data e themelimit, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

1. Sot më date 2018-02-12 ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **PREMAR ALB**

2. Themeluesit e shoqërisëjanë :

- Flamur Gjinaj me id H00202090R

### **Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria **PREMAR ALB SHPK** do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

1. Rikonstruksione, mirëmbajtje, ndërtimë civile, bujqesore, turistike dhe industriale me ose pa skelet metalik, veshje fasadash, punime carpenterie.
2. Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudhë, linja tramvaji, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Punime dheu, tarracime, sistemime.
3. Shërbime topografike, Gjeodezike, Maksheteri.
4. Shitje/blerje pasurie të tundshme ose patundshme
5. Pumime nëntokësore, ura vepra arti, pilota, etj.
6. Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje, kolektorë shkarkimi urbane dhe rurale, impiante vaditje, diga te vogla, damba, sifona, kaskada, kaperderdhës, tombino etj.
7. Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.
8. Punime për prishjen endërtimeve.



9. Impiante dhe sisteme elektrike, mekatronike, hidro-termosanitare, hidraulike, perpunime lendesh kimike, instalime mbrojtje dhe mirëmbajtja e tyre.
10. Vepra hidroteknike, galerie e tunele hidraulike, vepra te marrjes sndërtimeve ujite nga rezervuarndërtimevet, vepra tndërtimeve marrjes sndërtimeve ujite nga lumejtë dhe marrja e ujite me puse.
11. Sisteme kundra zjarrit.
12. Vlerësime financiare. Përgatitje tema reference. Hartim detyre projektimi. Hartime specifikimesh teknike. Metodologji, përshkrime dhe planifikime punimesh.
13. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturndërtimeve me punime druri, plastik, metalik, dhe xhami dhe rifiniture të natyre teknike ndërtuese.
14. Impiante të sinjalistikës ndricuese të trafikut. Sinjalistika rrugore jo ndricuese. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Impiante te brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni etj.
15. Ndërtime për N/stac.,kab. e transform. Linjë e Tensionit të ulet/mesëm/larte dhe shpërndarjen e energjisë.
16. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Punime mekanike, elektrike, trajtime teknologjike për materiale të tretshme dhe të ngurtë
17. Transport rrugor ndërkontrollor i udhëtarëve Transporti.
18. Transport rrugor ndërkontrollor mallrash për të tretë e me qira.
19. Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor.
20. Transport ndërkontrollor detar i automjeteve dhe/ose udhëtarëve.
21. Për shërbime portuale.
22. Për shërbime hekurudhore.
23. Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregimi i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri.
24. Shërbime të kujdesit shoqëror.
25. Shërbime të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe/ose formimit professional.
26. Agjenci udhëtimi dhe/ose operator turistike.

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Juef".

27. Impiante dhe sisteme elektrike, mekatronike, hidro-termosanitare, hidraulike, perpunime lendesh kimike, instalime mbrojtje dhe mirëmbajtja e tyre.
28. Vepra hidrotëknike, galerie e tunele hidraulike, vepra te marrjes sndërtimeve ujtit nga rezervuarndërtimevet, vepra tndërtimeve marrjes sndërtimeve ujtit nga lumejtë dhe marrja e ujtit me puse.
29. Sisteme kundra zjarrit.
30. Vlerësime financiare. Përgatitje tema reference. Hartim detyre projektimi. Hartime specifikimesh teknike. Metodologji, përshkrime dhe planifikime punimesh.
31. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturndërtimeve me punime druri, plastik, metalik, dhe xhami dhe rifiniture të natyre teknike ndërtuese.
32. Impiante të sinjalistikës ndricuese të trafikut. Sinjalistika rrugore jo ndricuese. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni. Impiante te brendshme elektrike, telefoni, radiotelefoni etj.
33. Ndërtime për N/stac.,kab. e transform. Linjë e Tensionit të ulet/mesëm/larte dhe shpërndarjen e energjisë,
34. Barriera dhe mbrojtje rrugore. Punime mekanike, elektrike, trajtime teknologjike për materiale të tretshme dhe të ngurta
35. Vlerësime gjeologo- inxhiniereike te truallit per godina civile, industrial, ekonomike dhe sociale. Konsolidimi i shkarjeve dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
36. Siperfaqe urbane, gjelberim, mbrojtje skrapatash, shpate me qendrueshmeri te ulet, mbetjeve urbane, materiale te ngurta (inerte etj).
37. Prodhim perpunim material inerte-gure, gure dekorativ etj.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat'

**Neni 4  
Selia**



**Neni 4**  
**Selia**

1. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Kashar, Yzberish, rruga 4 Deshmoret, kompleksi Fratari, Hyrja 2, ap.12
2. Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është:
3. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon flamur-gjinaj@hotmail.com

**Kreu II**  
**KAPITALI**

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 000.00 lekë.  
Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- a- Ortaku themelues Flamur Gjinaj zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 lekë që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të paluajtshme/të luajtshme apo të drejta).

**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendime në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin themeltar;
- b) shitblerjes ;



- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8** **Organi Vendimmarrës**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblene e përgjithshme, nëbazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**



## **Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10 Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 % të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votive, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo njete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

### **Neni 11 Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votive të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve;
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;

Çdo ndryshim statut duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

### **Neni 12 Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:



- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënien ose joë përfitimeve të reja;

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

### **Neni 13 Administrimi**

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë, Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo enërim i bërë në kundëshitim me këto dispozita është i pavlefshëm.
3. Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:  
(mbiemrat, emrat, adresat):

dhe specimenët e nënshkrimit:

Flamur Gjinaj

### **Neni 14 Kompetencat e Administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme përmiratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin përmes Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



- g) raportojnë përpara asamblesesë përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

-shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator , ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.Paditë qe lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

### **Neni 15 Përgjegjësitet e Administratorit**

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikësrisë, sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" administrator detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të



rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administrator vepron në kundështim me detyrat dhe shkel standartet professionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të këruara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundështim me dispozitat e ligjit

"Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthehen ortakëve kontributet;
- b) u paguhen ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndahen aktivet shoqërisë;
- d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë liguore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV Viti finanziar- ekspertët**

##### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti finanziar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mylllet më 31 Dhjetor.

##### **Neni 17 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollpjë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillëi ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohëortakëve për t'i shqyrtuar miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.



**Kreu V**  
**Prishja – riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 18**  
**Prishja dhe likujdimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo document të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “shoqëri në likujdim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përvajtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tsaj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**




### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Sgoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKËT**

### **E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PREMAR ALB shpk**

Flamur Gjinaj

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Flamur Gjinaj". The signature is fluid and cursive, with the name "Flamur" on top and "Gjinaj" below it. There is also a smaller, stylized signature or mark underneath.